



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
VLORE

Nr. 404 Akti
Dt.Regj.18.01.2016

Nr . 281. Vendimi
Date 04.03.2016

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Sot me date 04.03.2016, Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore e përbëre nga gjyqtari KEN DHIMA, asistuar nga sekretaria gjyqësore Kamila Petriti, shqyrtoi ne seance gjyqësore me dyer te hapura çështjen civile me Nr. 384 akti date 18.01.2016 qe i përket:

PADITES: Shoqeria ""NIMFA", me nipt NIPT K36630207I perfaqesues ligjor z. Azem Veliu me me adrese: Uji i Ftohte tek Vironi Vlore , perfaqesuar nga administratori Azem Veliu.

IPADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore , ne mungese Drejtoria e Apelimit Tatimor, prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, ne mungese.

PERSON I TRETE: Zyra Vendore e Avokatit te Shtetit Vlore, ne mungese.

OBJEKTI: Shfuqizimi i Akti Nr. 12516 prot. date 6.10.2015 Njoftim Vleresimi te DRT Vlore per shumen prej 300 000 leke dhe shfuqizimi i Vendimit te Drejtorise se Apelimit Tatimor nr. 32646/l Prot. date 22.12.2015.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore", i ndryshuar (Ligji per Procedurat Tatimore);Udhezimi nr.24

date 2.9.2008 "Per procedurat tatimore", i ndryshuar
(Udhezimi per Procedurat Tatimore); Kodi i Procedurave
Administrative i Republikes se Shqiperise Kodi i
Procedures Civile i Republikes se Shqiperise; Ligji nr.
49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave
administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve
administrative" (Ligji per gjykatat
administrative"; Kushtetuta e Shqiperise; Akte te tjera ligjore
dhe nenligjore perkatese.

Ne përfundim te shqyrtimit gjyqësor te zhvilluar me dyer te hapura gjykata pasi
dëgjoi paditësin i cili kërkoi pranimin e padisë sipas objektit , i paditurit ne
mungese edhe pse kishin dijeni rregullisht per gjykimin , pasi shqyrtoi provat e
administruara ne dosje dhe bisedoi ceshtjen ne tërësi, si përfundim,

VEREN

Se para Gjykatës Administrative te Shkalles se Pare Vlore pala paditëse Shoqeri
"NIMFA", ka paraqitur një padi me objekt dhe pale te paditura si me sipër.

Gjykata çmon se kjo padi është ne kompetencën funksionale te kësaj gjykate
konform nenit 10/1 te Ligjit Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e
Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative"
baze te te cilit përcaktohet se : "Gjykata administrative e shkallës së parë shqy
mosmarrëveshjet administrative të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, me
përjashtim të atyre që lidhen me aktin nënligjor normativ".

Gjykata çmon se është ne kompetencën lëndore te kësaj gjykate shqyrtimi i k
çështjeje pasi padia është një prej atyre te parashikuara ne nenin 7/a te Ligjit
Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative
Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" ne baze te te cilit rezulton se
mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligj
normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të
veprimtarisë administrative nga organi publik".

Gjithashtu gjykata çmon se është ne kompetencën tokësore te kësaj gjykat
shqyrtimi i kësaj çështjeje pasi sipas nenit 11/1 te Ligjit Nr.49/2012 "
Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjy
Mosmarrëveshjeve Administrative" ne baze te te cilit rezulton se : "Padi
veprimtarisë administrative shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës

që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet". Pala e paditur ne këtë proces është Drejtoria Rajonale Tatimore, Vlore.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se Shoqëria "Nimfa" me NIPT K36630207 I, është një shoqëri që kryen aktivitetin e saj në fushën e shërbimeve. Në Tetor të vitit 2015 ka marrë dënimin për "Njoftim vlerësimit" nxjerre prej Drejtorisë Rajonale Tatimore me nr 12516prot. date 6.10.2015 sipas të cilës në bazë të të dhënave që gjenden në DRT, subjekti "Nimfa" ka për të paguar gjoben prej 300.000 leke.

Me datën 07.08.2015 pranë subjektit Shoqëria "Nimfa" është kryer kontrolli tatimor i radhës, në përfundim të të cilit inspektoret përgjegjës kanë mbajtur akt - konstatimin me nr 0178658 sipas të cilit, ndër të tjera: "U konstatua se subjekti ka vendosur pajisjen fiskale për hotelin dhe pajisjen fiskale tjetër që janë në gjendje pune, ka dhe ju mor kupon tatimor, u konstatua se subjekti nuk ka prerë kupona tatimor për qarkullimin me leke në dorë tek cadrat dhe bazuar të ligji 9920 date 19.5.2008, neni 122 pika 1 germa "b" penalizohet 200 000 leke gjobe. Janë listuar emrat e punonjesve të subjektit, numri i dhomave të zena 37 dhe në përfundim akt konstatimi definon se: ... mbahet ky akt - konstatim për veprime të mëtejshme në administratën tatimore".

Duke mos qenë dakort me këtë akt, brenda afatit pala paditëse ka paraqitur ankim në Drejtorinë e Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme e cila me vendimin nr. 32646/l prot. date 22.12.2015 ka vendosur lënien në fuqi të Njoftim vlerësimi për detyrimet të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlore nr 12516prot, date 6.10.2015 dhe rrëzimin e ankimit.

Rezultoi e provuar gjatë shqyrtimit gjyqësor se prej palës së paditur DRT Vlore nuk është njoftuar palës paditëse akt-konstatimi dhe procesverbali i gjobës, përveç kësaj, pala e paditur DRT Vlore ka nxjerre njoftim vlerësimi për detyrim tatimor për një gjobe 50% me të lartë se dënimi i përcaktuar nga inspektoret, pra nga 200 000 leke në 300 000 leke.

Në aktin e njoftim vlerësimit për detyrimet nuk ka asnjë shpjegim dhe pala paditëse nuk është vënë në dënimin për shkaqet dhe bazën ligjore të kësaj gjobe, për më tepër që është dhe 50% më të lartë.

Sic konstatohet në aktin e mbajtur, inspektoret kanë kryer kontroll fizik në subjekt, kanë identifikuar numrin e dhomave, emer për emer të gjithë punonjesit, kanë konstatuar se janë dy pajisje fiskale në gjendje pune dhe ka dy konkluzione kontradiktore me tej: "I pari: subjekti ka dhe ju mor kupon tatimor për secilin kase; i dyti: u konstatua se subjekti nuk ka prerë kupon tatimor për qarkullimin me lek në dorë të cadrat", dhe mbi këtë bazë dhe ligjit 9920 date 19.5.2008, neni 122 pika 1 germa 'b/i' kanë konkluduar për 200 000 leke gjobe - neni 122 pika 1 germa

'b/i', procesverbal i cili nuk i është njoftuar dhe as i është bërë me dije për paditëse.

Pala paditëse pretendon se:

Se pari: Vendimi për dënim me gjobë është i pabazuar pasi shkelja as nuk qëndron as nuk është e arsyetuar dhe argumentuar.

Se dyti: Në pretendimet e saj pala paditëse evidenton se si në çdo hotel plazhi në Shqipëri e jo vetëm, në pagesën për dhomën e plazhit përfshihet edhe pagesa për çadër e plazhit. Sic ka evidentuar edhe grupi i kontrollit, hoteli ka patur 37 dhoma, të cilave ju korrespondojnë 37 çadra për të cilat pagesa përfshihet në kuponin tatimor për hotelin. Pagesa për këto dhoma është gjetur dhe evidentuar si e rregullt edhe nga inspektorët.

Se treti: Inspektorët në aktin e tyre nuk kanë shpjeguar nëse konkluzioni për dënim prej 200 000 leke ka të bëjë me këto 37 çadra që janë pjesë e shërbimit të dhomës së hotelit, apo për të tjera çadra, shërbim për pushuesit ditë në plazh.

Inspektorët kanë ushtruar kontroll pranë shoqërisë paditëse dhe aty kanë konstatuar se kjo shoqëri ka realizuar shitje pa lëshuar kuponin tatimor.

Neni 122 "Kundërvajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale, për lëshimin e kuponave fiskalë e të biletave" përcakton se:

1. Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se:

- a) nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të qarkullimit:*
- b) nuk lëshon kupon tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve:*

i) për çdo konstatim (verifikim) të kryer, me gjobë në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi fitimin, dhe gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për tatimpaguesit e tjerë;

Gjykata vlerëson se akti administrativ Njoftimi i Vlerësimit për Detyrimet Nr. 12516 prot. date 6.10.2015 lëshuar Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë dhe Vendimi Nr. 32646/l prot. date 22.12.2015 i nxjerre nga Drejtoria e Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Pergjithshme të Tatimeve janë me probleme ligjore thelbësore dhe proceduriale. Këto organe administrative kanë nxjerrë këto akte administrative me pasoja jo të vogla për paditësin dhe nuk ka dhënë arsytim bindës apo provë mbështetëse.

Inspektorët e palës së paditur kanë pretenduar se Shoqëria "NIMFA" nuk ka lëshuar kupona tatimor. Në këtë rast është përpiluar një akt konstatimi dhe më pas është lëshuar Njoftim i Vlerësimit të Detyrimeve Tatimore. Mirëpo pretendime të tilla nuk mund të lihen vetëm në kuadrin e konstatimit por edhe duhet provuar në formë të plotë shkresore. Çështja e moslëshimit të kuponit tatimor është një pretendim që nuk provohet nga pala e paditur.

Që të ndodhemi përpara këtij fakti duhet që të kryhej një shitje konkrete kundrejt

nje subjekti fizim apo juridik dhe kjo shitje te mosshoerohet me leshimin e kuponit tatimor prej shitesit. Pra pala paditese nuk provon se eshte kryer nje shitje e cila nuk eshte e shoqeruar me kupon tatimor, pasi nese do te ishte vertete ky fakt duhej te penalizohej edhe blesesi i cili nuk ka kerkuar te pajisej me kuponin tatimor. Inspektorët e palës së paditur nuk kanë paraqitur asnjë provë për të vërtetuar këtë pretendim. Kjo mënyrë konstatimi tejkalon procedurat normale të kontrollit ligjor sipas legjislacionit përkatës. Kjo formë kontrolli shkon drejt abuzimit dhe arbitraritetit. Pala e paditur ka per detyre te pasqyroje sakte ne procesverbal faktin konkret dhe jo ate te eventual te supozuar se kryhet shitje e pa shoqeruar me kupon tatimor. Pra, nuk kemi nje fakt te ndodhur qe te aplikohet kundrejt paditesit shkelja administrative e atribuar ketij subjekti.

Grupi i kontrollit ka patur te gjitha mundesite qe konform nenit 60 dhe 61 te Ligjit 9920 date 19.5.2008 te merrte informacion shtese, per te sqaruar dhe evidentuar pa asnje ekuivok perpara se te vendoste masen administrative gjobe ndaj subjektit. Gjykata cmon se konstatimet e grupit te kontrollit te kryera ne mungese totale te verifikimeve dhe hetimeve, jane te pamjaftueshme per te mbeshtetur denimin me gjobe ndaj paditesit.

Gjykata cmon se konkluzionet e inspektorve jane kontradiktore, jane te pabazuara ne fakte e rrethana konkrete te tyre. Klientet e hotelit e kane sherbimin e cadrave te paguar si pjese e pageses se dhomes, inspektorët e kontrollit nuk kane evidentuar diference te tille.

Nese behet fjale per cadrat ne sherbim te klienteve te hotelit (te cilet cadren natyrshem qe e kane pjese te pageses se hotelit) eshte e natyrshme qe denimi nuk qendron. Ndersa nese behet fjale per te tjera cadra, atehere do duhej te arsyetohej qartesisht se: sa cadra u gjeten pa kupone? sa i perkisnin hotelit e sa jo? Sa kupona tatimor kane konstatuar per cadrat , sa ishin prere nga subjekti i kontrolluar ? Sic shihet edhe ne aktin e konstatimit, inspektorët nuk kane percjelle asnje detaj per shkeljen.

Pala e paditur pa te drejtë dhe pa dhënë asnjë argument bindës i ka konsideruar disa fakte të paplota si shkelje administrative dhe ka llogaritur një detyrim financiar të padrejtë ndaj kësaj shoqërie. Inspektorët pa u informuar në mënyrë të plotë dhe përfundimtare kanë vendosur për të gjobitur palën paditëse. Pretendimet e palës së paditur në lidhje me kuponat tatimore nuk janë provuar në asnjë moment gjatë procesit gjyqësor. Nga akti i konstatimit rezultojnë pasaktësi të dukshme. Pavarësisht shënimeve përkatëse të inspektorëve në aktin e konstatimit, në këtë akt nuk janë hedhur në mënyrë të plotë dhe korrekte shkeljet e mundshme të gjetura tek shoqëria paditëse. Vetëm shënimi se nuk janë lëshuar kupona tatimor nuk përbën shkelje apriori. Cdo kundravajtje administrative duhet te evidentohet dhe te provohet ne menyre te plote.

Gjykata cmon se aktet administrative objekt gjykimi vijnë në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligj duke i bërë këto në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative si dhe të Ligjit për Kundravajtjet administrative.

Keshtu qe gjykata vlereson se duhet te shfuqizojë këto akte administrative, konkretisht aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Nr. 12516 prot. date 6.10.2015 leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore dhe aktit administrativ Vendimit nr. 32646/1 Prot. date 22.12.2015, leshuar nga Drejtoria e Apelit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme se Tatimeve si akte administrative te nxjerra ne kundërshtim me ligjin .

Sa me siper, gjykata cmon se kërkesapadia e Shoqeria ""NIMFA" është mbështetur në ligj dhe ne prova dhe si e tille ajo duhet pranuar .

Vlen te theksohet se ku vendim ne mbeshtetje te nenit 45 te ligjit nr.49/2012 « Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative » nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt:

...

b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;
Rezulton se ne rastin konkret masa e denimit administrativ kundrejt paditeit ka qene ne masen 300.000 leke dhe per rrjedhohe ndaj ketij vendimi nuk mund te kryhet ankim .

Për këto arsye

Gjykata ne baze te Ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore", i ndryshuar ("Ligji per Procedurat Tatimore");Udhezimi nr.24 date 2.9.2008 "Per procedurat tatimore", i ndryshuar ("Udhezimi per Procedurat Tatimore");Kodi i Procedurave Administrative i Republikes se Shqiperise , Kodi i Procedures Civile i Republikes se Shqiperise;Ligji nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative,

VENDOSI:

1. Pranimin e kerkesepadise si te bazuar ne prova dhe ne ligj.
2. Shfuqizimin e aktit administrativ Nr. 12516Prot, date 06.10.2015 "Njoftim vleresimi " te DRT Vlore per shumen 300.000 leke.
3. Shfuqizimin e vendimit te DAT Nr. 32646/1 Prot, date 22.12.2015.

4. Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales se paditur.
5. Ndaj ketij vendimi nuk leshohet urdher ekzekutimi.
6. Ndaj ketij vendimi nuk lejohet ankim, ai eshte i formes se prere
- 7 Urdherohet zyra e permbarimit me ekzekutimin e ketij vendimi menjehere

U shpall ne Vlore, sot me dt. 04.03.2016.

**SEKRETARE
KAMILA PETRITI**



**GJYOTAR
KEN DHIMA**

